BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

BIBLIOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS
"PJETËR BOGDANI"
THE NATIONAL LIBRARY OF KOSOVA
Nr. 9
Dt. 30/01/2023
Prishtinë

Sheshi "Hasan Prishtina" 10000, Prishtinë – Kosovë; Fax: +381 38 248 940; Tel: +381 38 212 416;
Posta elektronike: bkuk@biblioteka-ks.org; Ueb: ëëë .biblioteka-ks.org;

KONKURS

I.

Institucioni: Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

Titulli i punës: Tre (3) Zyrtar për Biblioteka 1

Kategoria funksionale /Koeficienti: 6

Referenca: RN00010781

Kodi: RPC0004445

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Bën përpunimin e (katalogimin dhe klasifikimin) botimeve monografike, serike dhe të gjitha materialeve të tjera bibliotekare, në gjuhën shqipe dhe të huaj, duke u bazuar në Rregullat Ndërkombëtare të Përshkrimit Bibliografik;
2. Bën përshkrimin bibliografik duke u bazuar në standardet e katalogimit të formatit MARC21 të sistemit të integruar bibliotekar;
3. Jep informacion bibliografik dhe orienton përdoruesit në burime të informacionit;
4. Bën Klasifikimin Lëndor dhe Klasifikimin Universal Decimal, sipas standardeve ndërkombëtare të klasifikimit;
5. Kryen përpunimin e materialeve bibliotekare, duke u bazuar në normën e punës;
6. Aplikon standardet profesionale;
7. Jep mendime dhe propozime për projekte;
8. Hartimi i raporteve për aktivitetet e kryera
9. Kryen edhe punë të tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit të sektorit dhe të drejtorit të BKK-së.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diplomë universitare (E noterizuar) nga Fakulteti Filologjik, Fakulteti Filozofik, FSHMN, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti Edukimit
2. Vërtetim që nuk është nën hetime nga Gjykata;
3. Aftësi organizative e nevojshme;
4. Njohje elementare e punëve profesionale në fushën e bibliotekarisë;
5. Aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit me palë dhe përdorues të materialit bibliotekar;
6. Shkathtësi kompjuterike në aplikacionet të programeve (Ëord, Excel, Power Point, Access)

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar, ndërsa kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj.

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e aplikimit nga 17.02.2023 deri më 03.03.2023.

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Të interesuarit mund t'i marrin aplikacionet dhe t' i dorëzojnë kërkesat e tyre dhe dokumentacionin në zyrën nr. 23, kati II, nga ora 9:00-12:00, apo përmes postës në adresën: Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani", Zyra e Personelit nr. 23 (aplikim për punë) Sheshi "Hasan Prishtina" p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë.